

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË

“Zerba & Co.” SH.P.K

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me Ortak të Vetëm

Sot, me datë 01.04.2024 (dymijë e njëzet e katër), në Durrës, pranë selisë së shoqërisë “Zerba & Co.” sh.p.k, me pjesëmarrjen e ortakut të vetëm z.Ledian Zerba, (më poshtë njohur si “**Ortaku**”) nënshkruhet ky Akt Themelimi, si vijon:

- **z.Ledian ZERBA**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi , me datë 29-12-1995 (njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë), mbajtës i pasaportës (ID) me Nr.BE8314911 dhe Nr.Personal J51229053T dhe banues në Durrës në Rr. Dibrës, njohur këtu e mëposhtë si ortaku i vetëm i shoqërisë me pjesmarrje në përqindje 100% (njëqind përqind), të kapitalit të shoqërisë “Zerba & Co.” sh.p.k.

I. Themelimi

Ortaku i vetëm deklaron në unanimitet të plotë, themelimin e shoqërisë “Zerba & Co.” sh.p.k, si një shoqëri tregtare shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).

1. Selia administrative e Shoqërisë është në adresën: **Rr. Dibrës, Nd.42, H.1, Rrashbull, Arapaj, Durrës, Shqipëri.**

Shoqëria është themeluar me afat të papërcaktuar.

II. Objekti

Në përputhje me statutin dhe liçensat e përfituara nga institucionet përgjegjëse, shoqëria do të kryej veprimtarite, si me poshtë:

Shërbimet financiare që përfshijnë analizat e kompanive publike dhe private që përfshijnë vlerësimin e performancës financiare të kompanive përmes analizës së pasqyrave financiare, treguesve kyç të performancës, dhe krahasimeve me konkurrentët për të ofruar një vlerësim të saktë i shëndetit financiar të kompanisë dhe perspektivave të saj të ardhshme; analizën e borxhit publik dhe privat përfshin vlerësimin e qëndrueshmërisë së borxhit të listuar dhe jo të listuar, duke përfshirë rrezikun e moskthimit dhe ndikimin e tij; shërbimet e këshillimit, auditimit, kontrollit ndihmojnë organizatat të menaxhojnë risqet financiare, të përmirësojnë performancën financiare, dhe të përmbushin kërkesat rregullatore; dhe shërbime të tjera financiare.

Shitje dhe Blerje të instrumentave financiarë si borxhi privat, publik, aksione të shoqërive publike ose private, instrumente speculative, etj.

III. Statuti

Ortaku i Vetëm z.Ledian ZERBA, deklaron pajisjen e Shoqërisë me Statutin e Shoqërisë.

IV. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 200,000 (dyqindë mijë) lekë, i përbërë nga 200 Kuota të Përgjithëshme. Kuota e shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë me numër të pjesëve 200,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind).

I gjithë kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm z.Ledian ZERBA, me vlerë kapitali në para 200,000 (dyqindë mijë) lekë, me numër të pjesëve 200,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind).

Çdo kuotë i jep të drejten e një votë zoteruesit të tij.

Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaku.

V. Administratori

Shoqëria do të drejtohet nga 1 (një) Administrator. Administratori do të jetë përgjegjës për administrimin e përditshëm të Shoqërisë “Zerba & Co.” sh.p.k, sipas kufizimeve të vendosura nga Statuti dhe legjislacionet e Republikës së Shqipërisë.

Administrator i Shoqërisë “Zerba & Co.” sh.p.k, emërohet:

- **z.Ledian ZERBA**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi, me datë 29-12-1995 (njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë), mbajtës i pasaportës (ID) me Nr.BE8314911 dhe Nr.Personal J51229053T dhe banues Durrës në Rr. Dibrës;
 - Administratori emërohet nga Ortaku në cilesinë e anëtarit të vetëm të Asamblesë së Përgjithëshme të Shoqërisë, i cilët ka të drejtë dhe kompetencë të plotë ta shkarkojë me vendim të zakonshëm Administratorin, për çdo arsye.
 - Administratori emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të ri-emërohet me vendim asambleje të përgjithëshme të ortakut/ ortakeve të shoqërisë.
 - Kompetencat dhe detyrat e Administratorit, mund të ndryshohen me vendim asambleje të përgjithëshëm të ortakut/ëve të shoqërisë.

Shoqëria “**Zerba & Co.**” sh.p.k, do të përfaqësohet ndaj të tretëve nëpërmjet nënshkrimit të vetëm të Administratorit të tij, të vendosur nën vulën e Shoqërisë, nëse nuk parashikohet ndryshe në Statutin e Shoqërisë dhe/ose në një vendim të ardhshëm të ortakut/ëve të shoqërisë.

ORTAKU I VETËM

z.Ledian Zerba

